



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2020:179231

Datë: 22.08.2024

Numri i dokumentit: 06077545

C.nr.1474/2020

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje me gjyqtarin Skender Shala dhe me bashkëpunëtorin profesional Burim Geci, në çështjen juridike të paditësit B.I, të cilin sipas prokurës më shkrim, e përfaqëson N.I, avokat në Komunën e Prishtinës, kundër të paditurit Kompania e Sigurimit ..., më seli në Komunën e Prishtinës, të cilën sipas autorizimit më shkrim e përfaqëson V V. Baza e kontestit “*Kompensim i dëmit*”, vlera e kontestit 19.602.75 Euro (*nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dy euro e shtatëdhjetë e pesë cent*). Gjykata, pas mbajtjes se seancës kryesore publike, datë 21.08.2024, në prezence të përfaqësuesve me prokurë të palëve ndërgjyqëse, më datën 22.08.2024, përpiloj me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit B I, pjesërisht e bazuar;
- II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimit ..., më seli në Komunën e Prishtinës, që paditësit, në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material, t’ia paguaj shumat si vijon:
 - Për dhimbje fizike të përjetuara, shumën prej 3500.00 Euro;
 - Në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë në shkallë prej 5 për qind, shumën prej 1500.00 Euro;
 - Ne emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 240.00 Euro;
 - Në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë, shumën prej 240.00 Euro;
 - Në emër të frikës së përjetuar, shumën prej 3500.00 Euro;
 - Në emër shpenzimeve të mjekimit, shumën prej 1352.75 Euro;

- III. OBLIGOHET e paditura, që paditësit, shumat e gjykuara si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguaj kamatë ligjore prej 8 për qind, e cila do të llogaritet nga data e ushtrimit të padisë në gjykatë (17.12.2020) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto (borxhin kryesor dhe kamatën ligjore) në afatin prej 15 (*pesëmbëdhjete*) ditësh, nën kërcënim të përmbarimit.
- IV. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë e pabazuar, më të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura Kompania e Sigurimit Prisig, më seli në Komunën e Prishtinës, që paditësit, në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material, t'ia paguaj shumat si vijon:
- Për dhimbje fizike të përjetuara, shumën prej 3500.00 Euro;
 - Në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë në shkallë prej 5 për qind, shumën prej 500.00 Euro;
 - Në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 160.00 Euro;
 - Në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë, shumën prej 560.00 Euro;
 - Në emër të shpenzimeve për rehabilitim dhe terapi fizikale, shumën prej 900.00 Euro;
 - Në emër të frikës së përjetuar, shumën prej 3500.00 Euro;
 - Në emër shpenzimeve të mjekimit, shumën prej 150.00 Euro;
- V. DETYROHET e paditura që paditësit, t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej njëzetë 1248.80 Euro, në afat prej 15 (*pesëmbëdhjete*) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësit, BI, (*tutje si paditësi*), nëpërmjet të autorizuarit të tij më prokurë, më datë 17.12.2020, pranë kësaj Gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimit Prisig, më seli në Komunën e Prishtinës (*tutje si e paditura*), lidhur më kompensimin e dëmit material dhe jo material.

Referuar përshkrimit në padi, më datë 03.08.2020, ora 17:40h, në fshatin ..., Komuna Vushtrri, ka ndodhur aksident i komunikacionit i përcjellë me dëme të mëdha materiale dhe jo materiale. I ka propozuar Gjykatës që të aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet e paditura kompensimin e dëmit material dhe jo material, si dhe të detyrohet e paditura që ti kompensoi shpenzimet e procedurës.

Tutje, Gjykata më datë 21.08.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, në të cilën prezantuan përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse.

Duke ju referuar pohimeve në padi dhe deklarimeve të dhëna gjatë procesit gjyqësor, dhe në fjalën përfundimtare (të cilën i autorizuari i paditësit e ka dorëzuar në gjykatë në formë të shkruar), paditësi përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë si dhe ka bërë precizimin e të njëjtës. I ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e precizuar, ta aprovon në tërësi të bazuar për të gjitha llojet e dëmit material dhe jo material, më kamat ligjore prej 8 për qind, nga data e parashtrimit të padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Përfaqësuesi i të paditurës, në seancën e shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare, mes tjerash ka deklaruar se nuk e konteston bazën juridike të kërkesëpadie, por e kundërshton precizimin e kërkesëpadisë, pasi që shumat e precizuara, janë jashtëzakonisht të larta, i ka propozuar gjykatës që të aprovoj shumat më të ulëta, duke pat parasysh lëndimet e paditësit si dhe praktikën gjyqësore.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Për të vlerësuar drejtë dhe për të vërtetuar gjendjen faktike lidhur me këtë çështje juridike, në shqyrtimin kryesor-publik të datës 21.08.2024, me propozimin e palëve, gjykata bëri administrimin e këtyre provave:

- Raporti i aksidentit, 2020-BR-419, datë 03.08.2020;
- Raporti i Qendrës Emergjente “Spitali Sheikh Zayed”, Vushtrri, datë 03.08.2020;
- Raporti i përgjithshëm emergjent, Spitali “Dr. Sami Haxhibeqiri”, Mitrovicë, datë 03.08.2020;
- Raporti mjekësor nga Qendra e Mjekësisë Familjare, si dhe Raporti nga Reparti i Radiologjisë dhe Neurologjisë;
- Ekspertiza mjeko-ligjore, e punuar nga ekspertet, Dr. Halit Gërbeshi-Ortoped dhe Dr. Shaban Mecinaj-Psikiater, datë 25.06.2023;
- Faturat në emër të paditësit.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, duke u mbështetur në normën e nenit 8 të LPK, më kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku.

Tutje, Gjykata ka vlerësuar legjitimitetin e palëve në procedurë dhe ka gjetur se të njëjtat janë të legjitimuara proceduralisht, prandaj konstatoi se kjo gjykatë është kompetente për të vendosur lidhur me këtë çështje kontestimore.

Neni 7 i LPK-së, shprehimisht thotë *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, ndërsa ne nenin 319 paragrafi 1 parashihet se *“Secila nga palët ndërgjyqese ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet edhe pretendimet e veta”*. Në rastin konkret, paditësit kërkon kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës 03.08.2020, në fshatin Nedakoc, Komuna Vushtrri.

Me provat e administruara, Gjykata ka gjetur se më datë 03.08.2020, ora 17:40h, në fshatin ..., Komuna Vushtrri, ka ndodhur aksident i komunikacionit i përcjellë me dëme materiale dhe jo materiale. Në atë mënyrë ku vozitësi i automjetit “A”, i cili ndërmerr veprim të pasigurt me rastin e kthimit gjysmë rrethor, ku godet automjetin “B”, me konkretisht në pjesën e përparme, ku automjeti “A” më anën e përparme ishte përplasur në automjetin “C”, në derën e pasme të majtë, i cili kishte qenë duke lëvizur në drejtim Prishtinë-Mitrovicë.

Deri te kjo gjendje faktike, Gjykata ka ardhur duke u mbështetur në baze të Raportit të aksidentit 22020-BR-419, datë 03.08.2020.

Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë së paditësit, gjykata sipas propozimit të autorizuarit të paditësit në seancën e datës 15.05.2024, ka nxjerr Vendim, më të cilin e ka aprovuar propozimin për nxjerrjen e ekspertizës nga lëmi i Ortopedisë-traumatologjisë dhe atë të Psikiatrisë.

Tutje, më datë 25.06.2024, Gjykata ka pranuar Raportin e ekspertizës të punuar nga Ekspert Dr. Dr. H G-Ortoped dhe Dr. ShM-Psikiater, të cilët kanë konstatuar se:

Paditësi, sipas ekzaminimeve të bëra, ka lëndime të renda trupore të cilat janë të shoqëruar më: Dhimbje të intensitetit posaçërisht të rëndë, 1 orë; Dhimbje të intensitetit të rëndë, 2 ditë; Dhimbje të intensitetit të mesëm, 20 ditë; Dhimbje të intensitetit të lehtë, 40 ditë; Zvogëlim të aktivitetit jetësor, 5 për qind; Shëmtim trupor nuk ka; Frikë primare e intensitetit posaçërisht të lartë, disa sekonda; Frikë sekondare të intensitetit të lartë, në kohëzgjatje prej 45 minuta; Frikë sekondare të intensitetit të mesëm, në kohëzgjatje prej 4 javësh; Frikë sekondare e intensitetit të ulët, vazhdon edhe tash; Ushqim i përforcuar, 30 ditë; Ndihmë e personit të tretë, 40 ditë; Terapi fizikale dhe rehabilitim 20 ditë.

Neni 9 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia përcakton *“Sigurimi nga auto përgjegjësia mbulon: dëmet në persona dhe pasuri të shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i mjetit Motorik”*.

Neni 10 i po të njëjtit ligj, i cili përcakton: *“Kompensimi i dëmit material dhe jo material bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve”*.

Ligji Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje si LMD), ndër të tjera rregullon çështjen e kompensimit të dëmit (material dhe jo material).

Neni 136 paragrafi 1, i këtij ligji ka paraparë së *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*.

Tutje neni 137 të LMD-së, përcakton se: *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”*.

Ndërsa në nenin 159 paragrafi 1 i LMD, është paraparë së: *“Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë”*.

Në nenin 169 paragraf 1 dhe 3 të LMD është paraparë së *“Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t`ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të demit”*.

Në bazë të nenit 173 paragrafi 1 të LMD-së është paraparë se *“I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur”*. Tutje paragrafi 3 i këtij neni parasheh së *“Gjatë vlerësimit të lartësisë së fitimit të humbur merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, e realizimi i të cilit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmerr veprimin”*.

Në nenin 179 paragrafi 1 dhe 2 të LMD, është paraparë së *“Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit. Në qoftë se i lënduari për shkak të paaftësisë së plotë ose të pjesshme për punë e humb fitimin, ose nevojat janë shtuar vazhdimisht, ose mundësitë e zhvillimit dhe të përparimit të tij të mëtejshëm janë zhdukur ose janë pakësuar, personi përgjegjës ka për detyrë t`i paguajë të lënduarit rentën e caktuar në të holla, si shpërblim për këtë dëm”*.

Kurse me dispozitën e nenit 183 paragrafi 1 e LMD përcaktohet se: *“Për dhembjet e pësuarat fizike, për dhembjet e pësuarat shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, të*

vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”.

Në përmbajtën e këtyre dispozitave ligjore, dëmi përfaqëson dëmtimin që e pëson një person i caktuar në të mirën juridike që mund të jenë personale dhe pasurore, më kusht që ato të jenë juridikisht të mbrojtura. Nga vetë përmbajtja e dispozitave të LMD, rezulton se ai që i shkakton dëm tjetrit, ka për detyrë t’ia shpërblej atë. Sipas dispozitave të cituara më lartë, për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit është e nevojshme të jetë shkaktuar dëmi, të dihet shkaktari i tij dhe të ekzistojnë parakushtet e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit mbi bazën e fajësisë apo mbi ndonjë bazë tjetër ligjore.

Tutje, në këtë kontekst kërkohet që veprimet apo mosveprimet e kryesit të dëmit në raport me dëmin e shkaktuar të jenë me dashje ose nga pakujdesia. Pra, qëllimi primar i shpërblimit të dëmit është rivendosja e gjendjes para shkaktimit të dëmit.

Mbi bazën e kësaj gjendje të vërtetuar faktike, dhe bazuar në dispozitat e sipërcituara, Gjykata vlerëson se e paditura mban përgjegjësinë për kompensimin e dëmit paditësit, pasi që shkaktuesi i dëmit ashtu edhe siç e kanë konstatuar ekspertet e fushës në ekspertizën e tyre, se lëndimet e pësuar kanë ardhë si pasojë e aksidentit të datë 03.08.2020.

Prandaj, gjykata pasi që i ka vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit material dhe jo material, posaçërisht duke marr parasysh natyrën dhe shkallen e dëmtimeve trupore të shkaktuar për paditësen, vlerësimi të ekspertizave mjekësore, aprovoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se shumtat e kompensimit të aprovuara janë adekuate, duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësit, dhe së ky kompensim do t’i mundësoj paditësit satisfaksion në mënyrë që i njëjta të jetë në gjendje që deri në një masë, t’i kompensoj të mirat jo materiale nga të cilat është privuar, e krejt kjo duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, sidomos sa i përket zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor i cili shprehet në shkallën prej 5 për qind. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit material dhe jo material, si dhe në lidhje me shumën kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash gjykata ka pasur parasysh moshën e paditësit rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cili i shërben ky kompensim, e gjithashtu kriteret e vëna nga praktika gjyqësore, për më tepër Gjykata i është referuar edhe Udhëzuesit GJ.A.Su.A 41/2023, datë 27.02.2023, për

caktimin e kriterëve orientuese dhe lartësisë së shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material, të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet me dëmin jo material dhe material, gjykata vendosi si në pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit, ku edhe nga ana e ekspertizës por edhe nga ana e provave të administruar në këtë çështje juridike, me konkretisht Raportet e Spitalit Royal Medical, nuk kanë lidhje kauzale me aksidentin, më saktësisht dy kuponët fiskal, dhe atë kuponin fiskal më numër 0030, datë 03.11.2020, në shumë prej 125.00 Euro dhe kuponin fiskal më numër 0007, datë 10.11.2020, në shumë prej 25 Euro.

Mandej, gjykata ka refuzuar edhe kërkesën për kompensimin e shpenzimeve në emër të rehabilitimit klimaterik, kjo për faktin se në shkresat e lëndës gjykata nuk gjeti asnjë provë, e më anë të së cilave (provës) mund të konstatohet se më të vërtet i padituri ka krijuar shpenzime për këtë kategori të dëmit, andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 7 paragrafi 1 të LPK, ku shprehimisht thuhet *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohet faktet e tilla”*, ndërsa me dispozitën e nenit 319 paragrafi 1 dhe 2, të po të njëjtit ligj shprehimisht thuhet *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta, ku të provuarit përfshihen në të gjitha faktet që janë të rëndësishme për dhënien e vendimit”* andaj, në mungesë të provave, fakti i cili ka të bëjë me pretendimin e paditësit sa i përket shpenzimeve në emër të rehabilitimit klimaterik ka ngel i pavërtetuar, prandaj në mungesë të kësaj, ka munguar edhe baza juridike për pretendimin e paditësit përkitazi me detyrimin e të paditurës për kompensimin e shpenzimeve të kërkuar, edhe pse ligjërisht si pale paditëse ka qene detyrë e tij, si pale e cila ka pretenduar se i takon e drejta e kërkuar dhe ka pasur mundësi që të propozon nxjerrjen e provave përkatëse në këtë drejtim, pasi që nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore dhe procedurale për një gjë të tillë, Gjykata vlerësoj se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në proporcion më të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejt.

Tutje, Gjykata gjithashtu ka vlerësuar edhe provat dhe pretendimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatën ligjorë të kërkuar nga paditësit, duke qenë se e paditura, ka rënë në vonesë lidhur me pagesën e borxhit të krijuar, gjykata ka vendosur që kamatë vonesa të jetë prej 8 për qind, duke u bazuar në nenin bazuar në nenin 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit padisë në gjykatë (17.12.2020), bazuar në Pikën XIV të Mendimit Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265/2020 të datës

02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur nga paraqitja e padisë është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452 paragrafi 1 të LPK, sipas të cilit pala e cila e humb kontestin tërësisht ka për detyrë që, palës kundërshtare, t'ia kompensojë shpenzimet gjyqësore. Në rastin konkret pala e paditur ka për obligim që paditësit të ia paguaj shpenzimet procedurale në shumën 208.00 Euro në emër të përpilimit të padisë, në emër të përfaqësimit (për 2 seanca nga 270.40 Euro) shumën prej 540.80 Euro, për ekspertize, shumën prej 400.00 Euro, taksës gjyqësore në shumën prej 100.00 Euro, përkatësisht shumën e përgjithshme 1248.80 Euro, nga keto arsye gjykata vendosi si në peken V të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Prandaj, gjykata, nga arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenet 4, 5, 7, 8 dhe 10 e lidhur me nenin 143 paragrafi 1 të LPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1474/2020, datës 22.08.2024

G j y q t a r i

Skender Shala

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e pranimit të te njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2020:179231
Datë: 22.08.2024
Numri i dokumentit: 06077545